



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 korrik 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesat
e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës
sipas Rregullës 153 të Rregullores**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) nxjerr këtë vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesat e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës sipas Rregullës 153 të Rregullores.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 qershor 2023, Trupi Gjykues nxori Vendimin mbi Kërkesat e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës sipas Rregullës 153 të Rregullores (Vendimi i Kundërshtuar), me të cilin pranoi deklaratat me shkrim dhe provat materiale shoqëruese të të dy dëshmitarëve të lartpërmendur në vend të dëshmimeve të tyre gojore, në pajtim me rregullën 153 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).¹
2. Më 30 qershor 2023, Mbrojtja e Pjetër Shalës (përkatësisht Mbrojtja dhe i akuzuari) kërkuan leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar (Kërkesa).²
3. Më 7 korrik 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj Kërkesës ("Përgjigja").³

¹ KSC-BC-2020-04, F00556, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Kërkesat e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës sipas Rregullës 153 të Rregullores*, 23 qershor 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 17 korrik 2023, F00556/RED.

² KSC-BC-2020-04, F00559, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesat e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës sipas Rregullës 153 të Rregullores*, 30 qershor 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 korrik 2023, F00559/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00573, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorit ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit sipas Rregullës 153*, 7 korrik 2023, konfidencial.

4. Mbrojtësi i Viktimave nuk dorëzoi përgjigje dhe Trupi Gjykses nuk mori në shqyrtim kundërpërgjigje.⁴

II. PARASHTRIME

A. MBROJTJA

5. Mbrojtja kërkon leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar bazuar në tri pika:

- (i) Nëse Trupi Gjykses gaboi që e interpretoi dhe zbatoi kushtin që lidhet me “veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit” në mënyrë kufizuese dhe jo në përputhje me nenin 6 të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“KEDNJ”)⁵ (Pika e Parë);
- (ii) Nëse Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysh dhe nuk zbatoi standardin e duhur për pranimin e ndërhyrjeve në të drejtën sipas nenit 6 të KEDNJ vetëm kur nevojitet për një qëllim të ligjshëm dhe kur masa e kundërshtuar është absolutisht e domosdoshme dhe masa më pak kufizuese (Pika e Dytë); dhe
- (iii) Nëse Trupi Gjykses gaboi që nuk i dha të akuzuarit mundësinë të ballafaqohet me TW4-02-shin dhe TW4-04-ën dhe, me këtë veprim, shkeli të drejtën e tij për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij (Pika e Tretë).⁶

6. Mbrojtja parashton se: (i) të tri pikat janë të apelueshme sepse janë mjaftueshmërisht konkrete, të sakta dhe burojnë drejtpërdrejt nga Vendimi i Kundërshtuar; (ii) të tri pikat ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procesit, si edhe në rezultatin e gjykimit, sepse lidhen me thelbin e të drejtave themelore të të akuzuarit për gjykim të drejtë, posaçërisht me të drejtën e tij për të

⁴ *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, para. 53, 54(g).

⁵ Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 4 nëntor 1950.

⁶ Kërkesa, para. 4.

marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij; dhe (iii) një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Apelit do ta avanconte thelbësisht procesin, sepse do të siguronte që ai të zhvillohej në përputhje me të drejtat themelore të të akuzuarit.⁷

B. ZPS-JA

7. Në përgjigjen e saj ZPS-ja parashtron se Kërkesa duhet hedhur poshtë meqë: (i) asnjë nga pikat nuk është e apelueshme, por shpreh thjesht mospajtimin e Mbrojtjes me Vendimin e Kundërshtuar; (ii) ato nuk kanë gjasë të ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit; dhe (iii) një vendim i menjëhershëm i Apelit nuk do ta avanconte thelbësisht procesin në këtë fazë.⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Trupi Gjykues mbështetet në nenet 21 dhe 45 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), rregullën 77 të Rregullores dhe nenet 36(3) dhe 43 të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Udhëzuesi i Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara).⁹

9. Trupi Gjykues përfshin përmes referimit standardin e lejes për apelim të përcaktuar në nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 77(2) të Rregullores dhe të përshkruar në vendime të mëparshme.¹⁰

⁷ Kërkesa, para. 12, 16-17, 32-35.

⁸ Përgjigjja, para. 1-4, 9, 12, 15-16, 18.

⁹ KSC-BD-15, Udhëzuesi i Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00587, Trupi Gjykues I, [Decision on the Defence's Request for Leave to Appeal and/or Reconsideration of F00538](#), (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim dhe/ose Rishikim të Vendimit F00538), 13 korrik 2023, publik, para. 8, 11-12; F00401, Trupi Gjykues I, [Decision on Request for](#)

IV. ANALIZË

A. ASPEKTE PARAPRAKE

10. Trupi Gjykues vëren se Kërkesa e tejkalon numrin e lejuar të fjalëve të përcaktuar nga Udhëzuesi i Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara për kërkesat për lejë për apel. Ndërsa mocionet në përgjithësi kanë një numër të lejuar prej 6.000 fjalësh,¹¹ kërkesat për leje për apel nuk duhet të jenë më shumë se 3.000 fjalë.¹² Kërkesa ka 4. 436 fjalë.¹³ Mbrojtja nuk ka kërkuar shtim të numrit të lejuar të fjalëve dhe as nuk ka dhënë arsye për të përligjur tejkalimin e numrit të lejuar.

11. Për arsye të kryerjes së shpejtë të procesit – dhe duke bërë një përjashtim – Trupi Gjykues e pranon Kërkesën në bazë të nenit 36(3) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara. Megjithatë, Trupi Gjykues rikujton dhe nxit Mbrojtjen që në të ardhmen të respektojë numrin e lejuar të fjalëve, ose të kërkojë ndryshimin e tij, përndryshe rrezikon që parashtrimet të konsiderohen si të vlefshme.¹⁴

Leave to Appeal the Decision Concerning Prior Statements Given by Pjetër Shala, (Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala), 24 janar 2023, publik, para. 13-20; F00116, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Decision on Application for Leave to Appeal “Decision on Motion Challenging the Form of the Indictment”*, (Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës) 29 nëntor 2021, publik, para. 11-13.

¹¹ Neni 41 i Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (KSC-BD-15).

¹² Neni 43 i Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara.

¹³ Kërkesa, f. 15.

¹⁴ *Shih edhe* KSC-BC-2020-04, F00401, Trupi Gjykues I, *Decision on Request for Leave to Appeal the Decision Concerning Prior Statements Given by Pjetër Shala*, (Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala) 24 janar 2023, publik, para. 12, ku Trupi Gjykues, në një situatë të ngjashme, i dha Mbrojtjes të njëjtat udhëzime.

B. VLERËSIM I KËRKESËS**1. Pika e Parë****(a) Parashtrimet**

12. Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykues gaboi që i bëri një interpretim “tepër kufizues” dhe mospërputhës me të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë shprehjes “veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit” në rregullën 153(1) të Rregullores, sikur ajo i referohet “ekskluzivisht veprimeve dhe mosveprimeve të të akuzuarit dhe nuk përfshin veprimet dhe mosveprimet e të tjerëve që mund t’i atribuohen atij sipas formave të përgjegjësisë penale për të cilat janë ngritur akuzat nga ZPS-ja”.¹⁵ Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykues nuk mori parasysh mënyrën se si mbështetet ZPS-ja në dëshmitë e TW4-02-shit dhe TW4-04-ës për të provuar sjelljet e pretenduara të të akuzuarit.¹⁶ Ajo parashtron se informacione të caktuara të dhëna nga TW4-02 në deklaratën e tij me shkrim faktikisht kanë të bëjnë me vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarit dhe se TW4-02 jep edhe “informacion tjetër të rëndësishëm”.¹⁷

13. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Parë përbën thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar dhe se Mbrojtja nuk ka vërtetuar gabimin e pretenduar të Trupit Gjykues.¹⁸

(b) Vendimi i Trupit Gjykues

14. Trupi Gjykues vëren se, veç pretendimit se Trupi Gjykues e ka interpretuar tepër ngushtë shprehjen “veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit”, në parashtrimin e saj Mbrojtja nuk vërteton se Trupi Gjykues ka bërë interpretim të gabuar. Mbrojtja thjesht

¹⁵ Kërkesa, para. 18, *ku citohet* Vendimi i Kundërshtuar, para. 32.

¹⁶ Kërkesa, para. 19.

¹⁷ Kërkesa, para. 21.

¹⁸ Përgjigja, para. 4-8.

pohon se informacione të caktuara të dhëna nga TW4-02 kanë të bëjnë me vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarit ose janë informacion “i rëndësishëm”.¹⁹ Mbrojtja nuk demonstroi se cili interpretim i dëshmisë së TW4-02-shit do ka të bëjë me vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarit dhe se si ai interpretim do të rezultonte në një përfundim të ndryshëm. Faktikisht, Mbrojtja nuk pajtohet me vendimin e Trupit Gjyqësor dhe kërkon të ribatojë para Panelit të Gjykatës së Apelit pranimin e deklaratave me shkrim të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës.

15. Sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se Trupi Gjyqësor gaboi që nuk mori parasysh mënyrën se si mbështetet ZPS-ja në dëshmitë e TW4-02-shit dhe TW4-04-ës dhe shkeljen vijuese të pretenduar të së drejtës së të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët, Trupi Gjyqësor është i mendimit se ky aspekt është pjesë përbërëse e Pikës së Dytë (dhe Pikës së Tretë) dhe, rrjedhimisht, është më mirë të diskutohet nën Pikën e Dytë.

16. Për këto arsye, Trupi Gjyqësor konstaton se Pika e Parë nuk përbën pikë të apeluarshme që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Meqë nuk përmbushet elementi i parë i standardit, Trupi Gjyqësor nuk e sheh të nevojshëm shqyrtimin e kërkesave të tjera dhe e refuzon lejen për Pikën e Parë.

2. Pika e Dytë

(a) Parashtrimet

17. Mbrojtja parashtron se Trupi Gjyqësor gaboi që e interpretoi të drejtën për të marrë dëshmitarët në pyetje në mospërputhje me nenin 6 të KEDNJ-së.²⁰ Ajo parashtron se pranimi i deklaratave me shkrim në vend të dëshmimeve gojore duhet të jetë “masë e përdorur si mjet i fundit” dhe “absolutisht e domosdoshme”.²¹ Gjithashtu

¹⁹ *Shih* Kërkesën, para. 18, 21.

²⁰ Kërkesa, para. 22.

²¹ Kërkesa, para. 24-25.

Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykses nuk ka dhënë arsye për kufizimin e të drejtës së të akuzuarit për të pyetur dëshmitarët kundër tij, të garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së dhe nuk trajton “aspak se përse Mbrojtjes duhet t’i hiqet çdo mundësi për të marrë në pyetje [dëshmitarët]”.²²

18. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Dytë nuk është e apelueshme sepse Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me vendimin e Trupit Gjykses, shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar, nuk merr parasysh arsyetimin dhe konstatimet e Trupit Gjykses, si dhe përsërit argumente të bëra më parë dhe të shqyrtuara nga Trupi Gjykses.²³

(b) Vendimi i Trupit Gjykses

19. Së pari, Trupi Gjykses konstaton se duke parashtruar se pranimi i deklaratave me shkrim në vend të dëshmive gojore duhet të jetë “masë e përdorur si mjet i fundit” dhe “absolutisht e domosdoshme”, Mbrojtja në fakt nuk i kundërvihet Vendimit të Kundërshtuar, por vetë rregullës 153 të Rregullores. Në këtë vështrim, Trupi Gjykses rikujton se Rregullorja u shqyrtua nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese dhe rregulla 153 i Rregullores nuk u konstatua të ishte në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës.²⁴ Siç ka vendosur edhe më parë ky Trup Gjykses, mospajtimi me Rregulloren nuk mund të jetë bazë për të formuluar një kërkesë në bazë të rregullës 77 të Rregullores.²⁵

²² Kërkesa, para. 25.

²³ Përgjigja, para. 9-11.

²⁴ KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [*Judgment on the Referral of the Rules of Procedure and Evidence Adopted by Plenary on 17 March 2017 to the Specialist Chamber of the Constitutional Court Pursuant to Article 19\(5\) of Law no. 05/L-053 on Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office*](#), (Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar), 26 prill 2017, publik, para. 186, 206.

²⁵ *Shih* KSC-BC-2020-04, F00587, Trupi Gjykses I, [*Decision on the Defence's Request for Leave to Appeal and/or Reconsideration of F00538*](#), (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim dhe/ose Rishikim të Vendimit F00538) 13 korrik 2023, publik, para. 14.

20. Së dyti, duke argumentuar se Trupi Gjykses nuk ka dhënë arsye për kufizimin e të drejtës së të akuzuarit për të pyetur dëshmitarët kundër tij, Mbrojtja nuk merr parasysh arsyetimin e Trupit Gjykses dhe keqinterpreton Vendimin e Kundërshtuar. Trupi Gjykses e trajtoi gjatë aspektin nëse paraqitja e deklaratave me shkrim të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës në vend të dëshmimeve të tyre gojore dëmtonte ose ishte në mospërputhje me të drejtat e të akuzuarit, dhe konstatoi se nuk ishte, sepse dëshmitë e tyre: (i) nuk kishin të bënin me vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarit; (ii) kishin kuadër të kufizuar; dhe (iii) ishin përsëritëse dhe/ose konfirmuese të dëshmimeve të dëshmitarëve të tjerë që janë paraqitur përpara Trupit Gjykses dhe që Mbrojtja i ka marrë në pyetje.²⁶

21. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se Pika e Dytë nuk përbën pikë të apelueshme që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Meqë nuk përmbushet elementi i parë i standardit, Trupi Gjykses nuk e sheh të nevojshëm shqyrtimin e kërkesave të tjera dhe e refuzon lejen për Pikën e Dytë.

3. Pika e Tretë

(a) Parashtrime

22. Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se paraqitja e deklaratave me shkrim të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës nuk dëmton të drejtat e të akuzuarit, sepse në fakt i mohon Mbrojtjes të drejtën për të marrë në pyetje, për t'u ballafaquar dhe për të kundërshtuar "dy dëshmitarë të rëndësishëm të Prokurorisë", të cilët japin dëshmi për "aspekte të rëndësishme" dhe "aktorë të rëndësishëm" në çështjen gjyqësore.²⁷ Gjithashtu Mbrojtja rikujton parashtrimet e saj të mëparshme se dëshmitë e TW4-02-shit dhe TW4-04-ës nuk janë as përsëritëse dhe as konfirmuese të

²⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 32-35, 39, 43-47, 49.

²⁷ Kërkesa, para. 26, 29, 31.

dëshmime të dëshmitarëve të tjerë dhe pretendon se Trupi Gjykses nuk i ka shqyrtuar këto parashtrime.²⁸ Së fundi, Mbrojta përsërit disa argumente të paraqitura në Pikën e Dytë.²⁹

23. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Tretë nuk është e apeluarshme sepse Mbrojtja përsëri thjesht shpreh mospajtim me vendimin e Trupit Gjykses, po përsërit argumente që janë shqyrtuar dhe hedhur poshtë nga Trupi Gjykses dhe nuk evidenton ndonjë gabim që me gjasë do ta zhvlerësonte Vendimin e Kundërshtuar.³⁰

(b) Vendimi i Trupit Gjykses

24. Trupi Gjykses konstaton se Mbrojta përsërit argumente tashmë të paraqitura, të shqyrtuara dhe të hedhura poshtë nga Trupi Gjykses dhe shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar. Në Vendimin e Kundërshtuar Trupi Gjykses shprehimisht konstatoi se dëshmitë e TW4-02-shit dhe TW4-04-ës kishin kuadër të kufizuar dhe se Mbrojtja nuk e shpjegon rëndësinë e atyre pikave që ajo i konsideron si “qendrore” në provat e ZPS-së.³¹ Gjithashtu, Trupi Gjykses e shqyrtoi veçanërisht nëse dëshmia e të dy dëshmitarëve ishte plotësuese dhe/ose konfirmuese e dëshmitarëve të dëgjuar drejtpërdrejt dhe konstatoi se ishte.³² Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me vendimin e Trupit Gjykses dhe kërkon ta hapë edhe një herë juridikisht çështjen përpara Panelit të Gjykatës së Apelit.

25. Duke qenë se Mbrojta përsërit argumentet e bëra në Pikën e Dytë, Trupi Gjykses i referohet vendimit të mësipërm dhe nuk do t’i shqyrtojë ato më tej.

26. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se Pika e Tretë nuk përbën aspekt të apeluarshëm që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Meqë nuk përmbushet elementi i

²⁸ Kërkesa, para. 26.

²⁹ Kërkesa, para. 28.

³⁰ Kërkesa, para, 12-14.

³¹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 33, 44, 46.

³² Vendimi i Kundërshtuar, para. 34, 45.

parë i standardit, Trupi Gjykses nuk e sheh të nevojshëm shqyrtimin e kërkesave të tjera dhe e refuzon lejen për Pikën e Tretë.

V. VENDIM

27. Për arsyet e mësipërme, Trupi Gjykses:

- a. **RRËZON** Kërkesën; dhe
- b. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes së saj (F00573) deri të premten, 21 korrik 2023.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E hënë, 17 korrik 2023

Në Hagë, Holandë.